

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 2536 Prot.

20

Vlorë më, 06.11.2024

VENDIM

Nr. 69, datë 31.10.2024

PËR

**MIRATIMIN E TARIFËS PËR PJESËMARRJE NË SEMINARIN E AKREDITUAR
NGA ASCK**

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, gërma ç, nenit 6, pika 30, pika 2, nenit 38, të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika i të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar propozimit të Administratorit, me shkresë nr. 1736/2 prot datë 16.10.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2024


VENDOSI:

1. Të miratojë paraprakisht tarifën për pjesëmarrje në seminarin e akredituar nga ASCK me vlerë 1,000 lekë sipas propozimit të ardhur nga Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik, në Fakultetin e Shëndetit sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.
3. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Fakultetit të Shëndetit dhe Qendrës Kërkimore Shkencore të Shëndetit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliq





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Nr. 1736/2 Prot.

Vlorë, më 16.10.2024

Lënda: Propozim për miratimin e tarifës për pjesëmarrje në seminarin e akredituar nga ASCK.

SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE
KRYETAR PROF. DR. AURELA SALIAJ

BORDIT TË ADMINISTRIMIT UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
Z. SOTIR NIKOLLA

Në zbatim dhe mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", shkresës së Fakultetit të Shëndetit, nr. 1736/1 prot., datë 14.10.2024 "Kërkesë për tarifë seminari" ku kërkohet miratimi i tarifës së pjesëmarrësve në seminarin e Akredituar nga ASCK me temë "Promovimi i ndërgjegjësimit për Hepatitin B në punonjësit e kujdesit shëndetësor – masat për parandalimin e infeksionit. Seminari do të zgjas 6 – orë, është akredituar me 5 kredite dhe tarifa e regjistrimit për pjesëmarrës është 1,000 lekë.

Bazuar në propozimin e Qendrës Kërkimor Shkencore të Fakultetit të Shëndetit tarifa për pjesëmarrësit do të jetë si më poshtë:


Emërtimi	Tarifa /lekë
Tarifë për pjesëmarrje në seminarin "Promovimi i ndërgjegjësimit për Hepatitin B në punonjësit e kujdesit shëndetësor – masat për parandalimin e infeksionit"	1,000

Bashkëlidhur: shkresa nr. 1736/1 prot., datë 14.10.2024.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

ADMINISTRATOR

Saimir XHELAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEKANI



Nr. 350/10 Prot.

Vlorë më, 14.10.2024

Lënda: Kërkesë për pagesë tarife seminari

Z. SAIMIR XHELAJ
ADMINISTRATOR, UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

Për djeni: **PROF. DR. AURELA SALIAJ**
REKTORE, UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË


KËTU

Bazuar në kërkesën e pedagoges Jerina Jaho me nr. 350 Prot., datë 09.10.2024 me lëndë "Kërkesë për miratimin e tarifës së pjesëmarrësve në seminarin e akredituar nga ASCK-Agjensia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror" si dhe bazuar në shkresën e Drejtueses së Qendrës Kërkimore Shkencore të Shëndetit Publik me nr. 350/1 Prot., datë 10.10.2024 për "Përcjellje e kërkesës të pedagoges Jerina Jaho, për miratimin e tarifës së pjesëmarrësve në seminarin e akredituar nga ASCK me temë "Promovimi i ndërgjegjësimit për Hepatitin B në punonjësit e kujdesit shëndetësor-masat për parandalimin e infeksionit", është e nevojshme të përgatitet tarifa e regjistrimit për pjesëmarrësit.

Bashkëlidhur gjeni shkresat e sipër përmendura.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin !

DEKANI
PROF. ASOC. ENKELEJD MËHILLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE E SHËNDETIT PUBLIK

Nr. 350/1 prot.

Vlorë, më 10 .10 .2024

Lënda: Përcjellje e kërkesës të pedagoges Jerina Jaho, Për Miratimin e Tarifës së Pjesëmarrësve në Seminarin e Akredituar nga ASCK me temë “Promovimi i ndërgjegjësimit për Hepatitin B në punonjësit e kujdesit shëndetësor-masat për parandalimin e infeksionit“

DEKANIT TË FAKULTETIT TË SHËNDETIT
PROF.ASOC. ENKELEJD MËHILLI

Këtu:

I nderuar z.Dekan!

Në përgjigje të kërkesës nr. 350 Prot, datë 09.10.2024 “Për Miratimin e Tarifës së Pjesëmarrësve në Seminarin e Akredituar nga ASCK-Agjensia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror”, për seminarin trajnues “Promovimi i ndërgjegjësimit për Hepatitin B në punonjësit e kujdesit shëndetësor-masat për parandalimin e infeksionit”, po ju përcjell për miratim kërkesën e pedagoges Jerina Jaho, koordinatore e e aktivitetit.

Bashkangjitur gjeni kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTUESE QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE E SHËNDETIT PUBLIK
PROF. ASOC. FATJONA KAMBERI

Nr. 330 prot.

Vlorë, më 04. 10 .2024

Lënda: Kërkesë për miratimin e tarifës së pjesëmarrësve në seminarin e akredituar nga ASCK-Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror

**DREJTUESES SË QENDRËS KËRKIMORE SHKENCORE TË SHËNDETIT
PUBLIK**


Prof.Asoc.Fatjona Kamberi

Në kuadër të aktiviteteve dhe seminareve të akredituara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, që ofron stafi akademik, për punonjësit e kujdesit shëndetësor, si koordinatorë e seminarit “Promovimi i ndërgjegjësimit për Hepatitin B në punonjësit e kujdesit shëndetësor-masat për parandalimin e infeksionit”, po ju paraqes kërkesën time për miratimin e tarifës që do të paguhet nga cdo pjesëmarrës në këtë aktivitet. Ky aktivitet 1-ditor, që do të zgjasë 6- orë, është akredituar me 5 kredite dhe tarifa e regjistrimit për cdo pjesëmarrës është 1000 lekë.

Bashkalidhur dokumentacioni përkatës i miratimit dhe akreditimit të seminarit nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror.

Ju falenderoj për bashkëpunimin!

Me respekt
Jerina Jaho





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE SHOQËROR
DREJTORIA E EDUKIMIT NË VAZHDIM

Nr. 2554/prot.

Tiranë, më 15/08/2024

Lënda: Mbi akreditimin e aktivitetit: "Promovimi i ndërgjegjësimit për hepatitin B në punonjësit e kujdesit shëndetësor - masat për parandalimin e infeksionit"

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Në përgjigje të aplikimit tuaj, nr. prot. 2554, datë 25.07.2024 dhe në zbatim të VKM 788, datë 22/09/2015 "Për përcaktimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë" i ndryshuar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror (ASCK) ka miratuar kërkesën tuaj për akreditimin e aktivitetit: "Promovimi i ndërgjegjësimit për hepatitin B në punonjësit e kujdesit shëndetësor - masat për parandalimin e infeksionit" dhe i ka njohur gjithsej 5 kredite.

Ky aktivitet akreditohet për kategoritë; Mjekë, stomatologë, farmacistë dhe infermierë.

Detyrimet tuaja të mëpasshme janë:


- Vendosja e shënimit në certifikatat e pjesëmarrësve "Ky aktivitet është i akredituar nga ASCK"
- Lëshimi i certifikatave individuale me numrin e krediteve të përfituara nga secili pjesëmarrës përlogaritur bazuar në kriteret e VKM-së së sipërpërmendur.
- Dorëzimi pranë ASCK-së, menjëherë mbas përfundimit të aktivitetit, i listës së pjesëmarrësve në aktivitet dhe i një përmbledhje të vlerësimeve të tyre;
- Kjo listë duhet të përmbajë dhe organizatorët/ lektorët e aktivitetit, që vlerësohen me dyfishin e krediteve; (me përjashtim të rasteve kur aktiviteti trajnuet zgjat më shumë se 7 ditë kalendarike, ku kreditet llogariten bazuar në orët reale të ofruara nga çdo lektor);

Në rast mosplotësimi të këtyre detyrimeve, ASCK ruan të drejtën e anulimit të akreditimit.

Faleminderit për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Denis GJIKA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I DREJTORISË SË STANDARDEVE, PROTOKOLLEVE
DHE AKREDITIMIT
Gjergji Alfonso Islami



Adresa

Rruga "Aleksander Moisiu"
Nr.84, Tiranë, Shqipëri

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SE KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE SHOQËROR

Tel: +355 4 2452286